



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 03.04.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti Nr. të protk (APK-DPKI-06-1516/24), për zyrtaren e lartë znj. Teuta Ukshini Aliu, Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" SH.A, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë respektivisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik për shkak se janë bërë ndryshimet, konform nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, duke hequr dorë nga angazhimi në veprimtarinë si eksperte financiare si dhe largimi nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat .
- III. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë znj. Teuta Ukshini Aliu, Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" SH.A, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë): " znj. Teuta Ukshini Aliu është kryesues e dy Komisioneve të Auditimit. Ajo është Kryesuese e Komisionit të Auditimit ne Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Anëtare e Bordit në KRU Prishtina, si dhe Kryesuese e Komisionit të Auditimit në KRU "Prishtina". Po ashtu znj. Teuta Ukshini Aliu, është edhe Eksperte e licencuara financiare apo Eksperte Gjyqësore. Ndërsa është identifikuar se e njëjta është përfaqësuese e autorizuar në një biznes privat".

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit,

Sipas procedurës së paraparë Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-1516/24, e ka njoftuar zyrtaren e lartë znj. Teuta Ukshini Aliu, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimeve të ngritur nga raportuesi i rastit për zyrtaren e lartë znj. Teuta Ukshini Aliu, Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" SH.A, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtaren në fjalë, me ç'rast e njëjta është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit të ngritura për konflikt të interesit.

Po ashtu të njëjtës i është bërë me dije se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejtë të ushtrojë veprimtarin e ekspertit të licencuar, si dhe nuk ka të drejtë të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat.

Në këtë takim, zyrtarja e lartë ka paraqitur argumentet dhe arsyetimet e saj lidhur me rastin në fjalë duke theksuar se: *"Në pozitën si kryesues e Komisionit të Auditimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, jam emëruara nga Ministria e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Në momentin kur jam emëruar me vendim të Ministres së Ekonomisë si kryesues e Komisionit të Auditimit në Kompaninë Rajonale të Ujësjiellësit "Prishtina" Sh.A, kam dhënë dorëheqje nga pozita e Kryesuese së Auditimit në MASHT. Tani jam vetëm anëtare e Bordit të Drejtoreshave dhe Kryesues e Komisionit të Auditimit në KRU "Prishtina" Sh.A".*

Nga informatat që përmban raportimi për konflikt të interesit nga raportuesi i rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur si dhe informacioni/dokumentacioni në dispozicion i siguruar sipas detyrës zyrtare, rezulton gjendja faktike si në vijim:

Me Vendimin nr. 08/81, datë 01.06.2022, Qeveria e Republikës së Kosovës emëron znj. Teuta Ukshini Aliu, Kryesues të Bordit të Drejtoreshave në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" Sh. A.; Vendimi me nr.05/186 për ndryshim dhe plotësimi të Vendimit nr.08/81, të dt. 01.06.2022, datë 24.01.2024, Qeveria e Republikës së Kosovës, emëron z. B.P. Kryesues të Bordit të Drejtoreshave në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" Sh. A.; Vendimi me nr. 01/5569, datë 09.09.2024, për ndryshimin dhe plotësimin e Komisionit të Auditimit të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit "Prishtina" Sh.A,

Ministria e Ekonomisë, emëron znj. Teuta Ukshini Kryesuese e Komisionit të Auditimit; Njoftimi për dorëheqje nga Komiteti i Auditimit në MASHT, të datës 12.11.2024, Ministres së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Njoftimi i datës 26.11.2024, Gjykatës Komerciale të Kosovës, për largim nga përgatitja e ekspertizës financiare;

Njoftimi i datës 26.11.2024, Gjykatës Themelore të Prishtinës, për largim nga përgatitja e ekspertizës financiare; Përgjigje në kërkesën për informacion, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (*informata zyrtare me nr. të protokollit DPKI-6-377/25, datës 28.03.2025*).

Bazuar në gjendjen faktike si më lartë, si dhe provat dhe faktet në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit

publik, nga zyrtarja e lartë znj. Teuta Ukshini Aliu, pasi që e njëjta ka dhënë dorëheqje nga pozita anëtare e Komitetit të Auditimit në MASHT, duke e njoftuar Ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit se nuk mund të jetë anëtare e dy komiteteve të auditimit, në të njëjtën kohë, duke u buzauar në Udhëzimin Administrativ 01/2019, për themelimin e Komiteteve të Auditimit në Sektorin Publik, ku neni 6 paragrafi 5 ka përcaktuar se *“Një anëtar i një Komiteti të Auditimit nuk mund të emërohet dhe të jetë anëtar në të njëjtën kohë në ndonjë komitet tjetër të auditimit”*, gjë që është konfirmuar edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (informata zyrtare me nr. protokoll: DPKI-06-377/25).

Ndërsa, sa i përket pretendimit të raportuesit të rastit, se znj. Teuta Ukshini Aliu, është edhe Eksperte e licencuara financiare apo Eksperte Gjyqësore, duke qenë se njëjta ka statusin e zyrtarit të lartë publik, sqarojmë se vlejnë kufizimet të cilat janë përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (LPKI), ku parashihen kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e veprimtarive të tjera krahas ushtrimit të funksionit publik:

“1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër. 2. Në kuptim të këtij neni, veprimtari profesionale nënkuptojnë veprimtaritë për të cilat kërkohet licencim sipas ligjit në fuqi.”

Prandaj në rastin konkret, znj. Teuta Ukshini Aliu, e ka njoftuar Agjencinë, se ka ndërmarr veprime duke e njoftuar Gjykatën Komerciale të Kosovës dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, se nuk do të angazhohet si eksperte financiare derisa e ushtron pozitën si Anëtare e Bordit të Drejtoreve dhe Anëtare e Komitetit të Auditimit në ndërmarrjen publike KRU “Prishtina” Sh.A.

Gjithashtu, znj. Teuta Ukshini Aliu, ka ndërmarr veprime sipas obligimeve që rrjedhin nga kufizimet për zyrtaret e lartë të parapara me nenin 13 paragrafi 1 dhe nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (LPKI), duke hequr dorë nga përfaqësuesi i Autorizuar në biznesin privat: *“RE INVESTMENT” SH.P.K.*

Kësisoj, me veprimet e ndërmarr nga zyrtarja e lartë, janë krijuar rrethana të atilla me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë respektivisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

III. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: ***“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”***, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: ***“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”***

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:


Ylli BULESHIKAJ
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)